



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA URA VAJGURORE

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT, INVESTIMEVE, KONTROLLIT TE PROJEKTEVE, E SHERBIMEVE PUBLIKE,
STREHIMIT DHE TRANSPORTIT

Nr. 4917/2 Prot

Ure Vajgurore 13/12/2016

LËNDA: Dorëzimi i Dokumentacionit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Ura Vajgurore dhe kërkesa për Miratimin e Përputhshmërisë

Drejtuar: Znj. Adelina Greca

Drejtor

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

E nderuar Znj. Greca,

Në vijim të procesit për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, proces ky i nisur që prej shtatorit 2015, Bashkia Ura Vajgurore në bashkëpunim me Studion "GAIA" ka përgatitur Raportin Përfundimtar të Planit të Përgjithshëm Vendor, dhe marrjes së miratimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, në përputhje me Ligjin 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, dhe akten nënligjore në zbatim të tij.

Për sa më sipër, Kërkojmë nga ana Juaj lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Ura Vajgurore.

Bashkëlidhur ndodhet Material i plotë elektronik i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Ura Vajgurore në CD

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin

KRYETAR I BASHKISË

JULIANA MEMAJ



Adresa :Rruga Dimal,
Lagjia" 18 Tetori " Ura Vajgurore

Telefon/faks 035536122639
mail:bashkiauravajgurore@gmail.com